REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

---

VENDIM

Nr. 34 Dt. 13.02.2017

"PËR MIRATIMIN E LEJES PËR HAPJE PUS -SHPIMI"

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 51 dhe nenit 52 të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave " Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje për përdorim të burimeve ujore", bazuar në relacionin e paraqitur nga A.B.U. Drin – Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe opinionit të DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore. Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë:

Vendosi:

1- Miratimin e lejes për hapje pus- shpimi në Fshatin Pjetroshan, Bashkia Malësi e Madhe.Qarku Shkodër , Z. Prek KEKA për ujitje në bujqësi.
Sipas studimit të paraqitur nga subjekti pusi i shpimit me Nr. **2P/2015** do të ketë këto të dhëna:
Koordinatat e pusit të shpimit X – 46 79 942 Y – 43 72 048 Z – 127
Thellësia e pusit 210 m
Prurja e pusit 5 l/sek
2- Në zbatim të nenit 56 pika 3 të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", subjekti jo më vonë se një muaj pas përfundimt të shpimit duhet të paraqesë pranë ABU Drin- Bunë një raport të hollësishëm hidrologjik në lidhje me shpimin, me mostrat e formacioneve të shpuara si dhe gjithë dokumentacionin përkatës.
3- Ngarkohet A.B.U. Drin- Bunë për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR
Marin PLLUMBI

KRYETAR
Paulin RADOVANI